



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:030725

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05772612

E.nr.751/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit S.O. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Fatos Pira nga Vitia, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtorja e Arsimit, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 03.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.751/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.751/23, të datës 22.09.2023 e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtorja e Arsimit, për pagesën e licencimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit 2020:030725, të datës 12.01.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 22.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,250.86 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.751/23, më datë 03.06.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi